

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama bëri lojëra të mëdha me kufijtë e Kosovës, tani lan duart si Ponc Pilati", Berisha zbulon prapaskenën me Hillary Clinton
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/rama-beri-ne-lojera-te-medha-me-kufijte-e-kosoves-tani-lan-duart-si-pon-i401492
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 20:31:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 20:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a1d7e2b81b4ca9ea0027d3adc7b8d09b087f5e06515ec1f5b95adbb0caabafa9
TEKSTI	1f98f756a4fe1b1608e792dff0cf7829cece687053ddfbcd1fae4811b2df10b9
PAMJA	1e2166c5d71f8b77beac1937554cbcd788b08088a6087db86da3a77836613f60

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4bb4e2880088facef82910bbd7d716ba7f1f51e1342e28fa4fa810d74c7cc30b
E MËPARSHMJA	44118fc9fbb493e0cf54e089b8e52f3543c22d1e646162b4a5f0c1f51e1c4e9c
RRËNJJA MERKLE	3b121f0f38f9983afad61fe399871208f196860b9a8965bfd896e6b91a545c4e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/4bb4e2880088facef82910bbd7d716ba7f1f51e1342e28fa4fa810d74c7cc30b

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Politikë

17 Shtator 2026, 22:15

Rama bëri lojëra të mëdha me kufijtë e Kosovës, tani lan duart si Ponc Pilati", Berisha zbulon prapaskenën me Hillary Clinton



Shkruar nga Newsbomb



Sali Berisha, Edi Rama, Hillary Clinton

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, në një bisedë me gazetarin Blendi Fevziu, ka akuzuar kryeministrin Edi Rama se ka futur Kosovën në "lojëra të mëdha" që çuan deri te krijimi i Gjykatës Speciale, dhe se sot po bën teatër duke larë duart si Ponc Pilati.

Berisha tha se deri në vitin 2013 nuk kishte asnjë diskutim për gjykatën dhe as për ndryshime kufijsh, sepse Tirana nuk kishte patronazh mbi Kosovën.

"Këta filluan lojëra të mëdha dhe këto lojëra të mëdha i bëri Edi Rama. Këta filluan lojëra të ndarjes së territoreve, ndarjes së kufijve, ato para ngritjes së aktakuzës. Deri në vitin 2013 s'pati asnjë gjë. Nuk bëhej sepse nuk kishte patronazh Shqipëria, Tirana mbi Kosovën", u shpreh Berisha.

Ai kujtoi qëndrimin zyrtar të qeverisë së tij ndaj raportit të Dick Martyt, duke thënë se Tirana e ka konsideruar gjithmonë shpifje të frymëzuar nga serbët dhe rusët. Berisha zbuloi edhe një episod me ish-sekretaren amerikane të Shtetit, Hillary Clinton, e cila sipas tij i kishte kërkuar një deklaratë mbështetëse për një marrëveshje që negociohej në Bruksel.

"Më ka kërkuar njëherë Hillary Clinton që të bëja një deklaratë. I thashë: zonja sekretare, unë atë nuk mund ta bëj. Do ta bëj pasi ta firmosin. Kosova kishte nevojë për sovranitet dhe jo vasalitet dhe nuk kishte nevojë aë t'i diktonte Sali Berisha as Edi

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

"Pagat kalojnë vetëm nga dera e ligjit", Ministri Gogu: Askush s'mund t'ia caktojë vetes rogen



Ekonomi

Rikonstrukcioni i rrugës Kombinat-Ndroq-Plepa, kompania "G.P.G" shpallet fituese e Lotit 3 me ofertë rreth 10 milionë euro

Zbulu më shumë artikuj >

Rama", tha ai.

Duke folur për themelin ligjor të akuzave ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Berisha hodhi poshtë tezën e linjës komanduese. Sipas tij, Thaçi dhe Krasniqi kanë qëndruar gjatë luftës në Shqipëri, madje në hotel Rogner, dhe nuk mund të flitet për një zinxhir komandues të zhdërvjellët. Ai e krahasoi rastin me dënimin e ish-shefit të shërbimit sekret serb, Jovica Stanishiq, me 6 vite burg, megjithëse kishte bashkëpunuar me CIA-n.

"Nuk mund të isha dakord kurrë që të përdorej linja e komandës. Këta ishin bashkëpunëtorë të hapur, publikisht, krahu i aleatëve. Këta kanë qenë në Rogner, zotëri. Të pretendosh se këta kishin linjë komande nuk është absolutisht e vërtetë", deklaroi Berisha.

Kritikën më të fortë Berisha e bëri për paraqitjet e Ramës në Washington dhe në Këshillin e Europës. Sipas tij, Rama e përmendi çështjen e Speciales aty ku nuk duhej dhe në një mënyrë që publiku e ngatërroi me Vjosa Osmanin.

"Çfarë nevojë kishte ky për teatralitetin që bëri në Washington? E përmendi para presidentit aty ku s'duhet ta përmendte në asnjë mënyrë. Ai e bëri sa për të larë gojën dhe e bëri në një mënyrë shumë të shplarë. Lau duart si Ponc Pilati. Ky është kryetar qeverie, ka çdo të drejtë t'i drejtojë një letër presidentit të SHBA, jo të bëjë teatër", tha Berisha.

Ai shtoi se e njëjta skenë u përsërit në Këshillin e Europës, kur prokuroria ndërkombëtare hodhi poshtë akuzën për trafik organesh, moment që sipas Berishës duhej shfrytëzuar nga Shqipëria për të kërkuar korrigjimin e rezolutës së Dick Martyt.

"Shqipëria kishte çdo të drejtë ligjore dhe diplomatike të kërkonte modifikimin e rezolutës. Çfarë bëri ky? Shkoi aty sikur të ishte i biri i Enver Hoxhës ose Gedafit, filloi të shajë deputetët. Saqë i anuluan drekën. S'ka ndodhur kurrë në Këshillin e Europës. Dreka anulohet", përfundoi Berisha.

Sondazh


Poll

Lexo gjithashtu



E Enjte 21:50

**"I dërgova Trumpit letër dhe ai e lexoi",
Berisha zbulon emrin e kompanisë së
lobimit për heqjen e "Non Grata"-s: Ja sa
kam paguar**





Politikë

Ngritja e Gjykatës Speciale që dënoi me 81 vite burg ish-krerët e UÇK-së, Berisha e zbulon për herë të parë: Hillary Clinton ma kërkoi ta mbështesja

E Enjte 21:26



Politikë

"Nuk mban më ujë pilafi", Mirela Kumbaro dhe Tërmet Peçi firmosin shkresën për kryetarin e djathtë të Memaliaj: Jemi të shqetësuar për banorët, ti nuk po bën asgjë (VIDEO)

E Enjte 19:37



E Enjte 17:18

Taulant Balla publikon VIDEON! Dje i jepte meritat për luftën, kur Sali Berisha "nxinte" Hashim Thaçin: Argat i serbëve! Vrau 200 anëtarë të LDK-së



Politikë

"Çfarë duhet të ndodhë, që Jakup Krasniqi të vdesë në burg?" Spiropali e emocionuar, thirrje deputetëve: Të mbështesim financiarisht betejën për mbrojtjen e tyre

E Enjte 15:32



Politikë

Shqipëria dënon aktgjykimin e Hagës, Kuvendi me deklaratë: Lufta e UÇK-së ishte lufta e një populli për çlirimin

E Enjte 15:16



E Enjte 14:05

"Mblijdh mendjen e hiq dorë nga detyra, pi një kafe me Karçanaj!" Berisha LËVDATA Evis Salës e kritika Spahiut, ministrja: Keni qenë profesori im...



Politikë

"Në 100 orët e para, s'kam pushuar asnjë sekondë!" Spahiu me premtime për Onkologjikun: Unë përballëm nëse nuk ofrohen shërbimet mjekësore

Enjte 13:32 Newsbomb



Politikë

"Njerëzit e punës s'mund të përgojohen", ministrja e Shëndetësisë premton në Kuvend: Ose e sjell atë PET Scan ose jap DORËHEQJEN

Enjte 13:20



Enjte 12:40

Me emblemën e UÇK-së pranë zemrës, Sali Berisha bën fajtor Edi Ramën: Ti dhe Vuçiç jeni përgjegjës për atë që ndodhi në Hagë



Politikë

Kumbaro flet me SHIFRA për arsimin: 1200 nxënës u zhvendosën nga privati në shtet, qeveria ka ndihmuar financiarisht gjeninun nga Cërriku

Enjte 12:28 Newsbomb



Politikë

Marjana Koçeku flet për marrëdhëniet me deputetët socialistë, ndalet edhe te kërcënimet nga grupi i Bajrave

Enjte 12:14





🕒 E Enjte 11:30

Deklarata e përbashkët për vendimin e Haaës nxit DEBAT në Kuvend. Kapri:

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.